



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:269658

Datë: 23.02.2023

Numri i dokumentit: 04005899

A.nr.200/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësve P. P., Z. R., S. R. dhe Z. I. të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati V. P., kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit 03/2756/17 të datës 16.01.2018, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 23.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve P. P., Z. R., S. R. dhe Z. I. , të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati V. P., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi 03/2756/17 i datës 16.01.2018 i Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me praninë e të dy palëve ndërgjyqëse.

Paditësi me padinë e datës 06.02.2018 kërkon nga Gjykata anulimin e vendimit përfundimtar të të paditurës. Pohon se e paditura ka marrë nga paditësja dokumentet origjinale, si dhe të gjitha provat e tjera se ajo ishte e regjistruar si pronare e kësaj pasurie të paluajjtshme që në vitin 1995, por një vendim të tillë e ka marrë në mënyrë të njëanshme dhe të pabarabartë duke i trajtuar të gjithë qytetarët, gjë që vë në dyshim fakti që të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit, pasi është sjellë siguria juridike, të cilat janë postulatet bazë të sistemit juridik dhe demokracisë në tërësi. I propozon Gjykatës që padinë ta aprovoj si të bazuar dhe të anulohet vendimet e të paditurave.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësve deklaroi: *“Mbesim pranë padisë dhe të gjitha provave të bashkangjitura, konsiderojmë padinë e bazuar sepse e paditura nuk ka vepruar sipas vendimit të plotfuqishëm gjegjësisht sipas ujdisë gjyqësore C.nr.238/95 i dt. 27.09.1995, e lidhur para Gjykatës Komonale në Viti. Me këtë ujudi gjyqësore paditësve paluajtshmëria ju është kthyer gjegjësisht ju është pranuar e drejta e pronësisë dhe me ujudinë njëjtë ju është bërë regjistrimi në kadastrë mirëpo ai dokumentacion për neve për arsye të panjohur është marr në Krushefc dhe tani paditësit kanë ushtruar kërkesë të re për regjistrim të përsëritur nga operatori kadastral dhe kjo kërkesë në shkallë të parë dhe të dytë është refuzuar si e pa bazë. Konsiderojmë se ujudi gjyqësore e ka klauzolën e ë plotëfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë dhe konsiderojmë se kjo duhet të zbatohet.*

Thëniet e palës së paditur që unë nuk e posedoj autorizimin gjegjës nuk qëndrojnë sepse është praktik e praktikume e zakonshme që avokati mund të veproj edhe me autorizimet të cilat nuk janë të vërtetuara tek noteri ndërsa për përmbajtjen e autorizimit të tij personalisht përgjigjen avokatët duke pasur parasysh se ata e vejnë faksimilen dhe nënshkrimin e tyre në ato autorizime. Gjithashtu nëse nuk ka qenë autorizimi adekuat ata kanë mundur të kërkojnë që në një afat të caktuar të dorëzohet autorizimi dhe ujudia gjyqësore është dorëzuar në afat të paraparë nuk e di a ka qenë origjinali apo kopja identike e origjinalit dhe nëse kjo ujudi gjyqësore do të ishte e falsifikuar ose eventualisht ekzistojnë indicionet për një gjë të tillë ka mundur të iniciohet procedura gjyqësore pasë paraprakisht procedura penale. Është e ditur se në disa gjykata në Kosovë është zhdukur dokumentacioni si në gjykatë ashtu edhe në organet komunale dhe i njëjti rast është edhe në Gjykatën Komonale në Viti, gjithashtu konsiderojmë se duhet të ekzistoi siguria juridike mos zbatimin e vendimeve të gjykatës paraqet ekzistimin e veprës penale”.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Propozoj që gjykata të aprovoi padinë e paditësve në tërësi dhe ta obligoi të paditurën të bëjë regjistrimin e të gjitha paluajtshmërive të cilat janë të cekura në Ujudinë Gjyqësore e të cilat gjyqtari i ka lexuar si procesverbal C.nr.238/95 dt. 27.09.1995, në afat prej 15 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë si dhe të paguaj shpenzimet gjyqësore dhe atë për përpilim të padisë dhe për një seancë gjyqësore”.*

E paditura me përgjigjen në padi të datës 30.09.2022 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësës si të pabazuar për shkak se duke u bazuar në Përgjigjen me numër 149/2016 të datës 28.10.2016 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti dhe duke ju referuar nenit 8, paragrafi 8.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.MSHP 2004/03 për Zbatimin e Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme i cili thotë: *“Para refuzimit të regjistrimit për arsyet e dhëna në nenin 3.4 (ii) ose (iii) të Ligjit mbi Regjistrin (psh. dokumentet e paraqitura përmbajnë parregullsi ose është në pyetje vlefshmëria e dokumenteve, ZKK-ja do të kërkojë nga Gjykata kompetente të qartësojë parregullësitë apo dokumentet me vlefshmëri të pasigurt, ashtu që aplikanti të paraqes dokumentacion shtesë, poashtu autorizimi i datës 14.10.2015 nuk është vërtetuar nga organi kompetent, andaj AKK refuzon ankesën si të pabazuar dhe i propozon Gjykatës që ta refuzoj padinë si të pabazuar dhe të vërtetojë aktvendimin e AKK-së.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e të paditurës deklaroi: *“Në tërësi pranë përgjigjes në padi ku AKK pas shqyrtimit të ankesë dhe shkresave të lëndës me vendim të dt.*

16.01.2018 e refuzon ankesën e palës si të pa bazuar duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 3.4 pika iii të Ligjit nr.2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme, si dhe dispozitën e nenit 8 paragrafi 8.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/03 për zbatimin e ligjit mbi themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme. Vlen të theksohet se autorizimi i dt. 14.10.2015 me të cilin Av. V. P. paraqitet në cilësi të autorizuarit nuk është i vërtetuar në organet kompetente duke iu referuar Ligjit për Noteri neni 3332 paragrafi 2”.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Në bazë të asaj që është vendosur me aktvendimin e dt. 16.01.2018, dhe në bazë të përgjigjes në padi i propozojmë gjykatës të nxjerr aktgjykim me të cilin do të refuzoj padinë paditësve si të pa bazuar dhe ta vërtetoi aktvendimin e AKK”.*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi me numër protokollit 845/2016 dt.29.12.2016, aktvendimi me numër reference 03/2756/17 dt. 16.01.2018, procesverbali me numër PBR 238/95 i dt.27.09.1995 i vërtetuar sipas vërtetimit noterial me numër LRP nr.3865/2015 dt.03.11.2015, vërtetimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan dega në Viti me numër GJA.nr./149/2016 i dt. 28.10.2016, autorizimi i dt. 14.10.2015, certifikata e listës poseduese e dt. 22.11.1995, certifikata e njësisë kadstrale me numrë P-70101014-01090-4 e dt. 29.02.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësve është e pabazuar.

Gjykata gjeti se Vendimi përfundimtar i kontestuar nga paditësit, është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi, përkatësisht konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Sa i përket vendimit përfundimtar të marrë nga e paditura, gjykata gjeti se e paditura ka marrë vendim në përputhje me ankesën e paditësve dhe vendimi i atakuar i Agjencisë Kadastrale të Kosovës përmban dhe përmbushë të gjitha kushtet dhe elementet ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Struktura formale e vendimit, është në përputhje të plotë me nenin 47 të LPPA-së, ashtu sikurse edhe arsyetimi i dhënë, përputhet në tërësi me nenin 48 të po të njëjtit Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se paditësit as me padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk ofruan prova të mjaftueshme për ti mbështetur pohimet e tyre të cilat do të dëshmonin se me vendimin kontestues të të paditurës, u është shkelur ndonjë e drejtë e përcaktuar me ligj.

Gjykata i mbështeti si plotësisht të drejta dhe të ligjshme arsyet mbi bazën e të cilave është marrë aktvendimi i kundërshtuar dhe në këtë drejtim përkrahi arsyetimin e të paditurës të dhënë në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar se e refuzon ankesën e palës si të pabazuar për shkak se duke u bazuar në Përgjigjen me numër 149/2016 të datës 28.10.2016 të lëshuar nga Gjykata

Themelore në Gjilan-Dega në Viti dhe duke ju referuar nenit 8, paragrafi 8.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.MSHP 2004/03 për Zbatimin e Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme i cili thotë: *“Para refuzimit të regjistrimit për arsyet e dhëna në nenin 3.4 (ii) ose (iii) të Ligjit mbi Regjistrin (psh. dokumentet e paraqitura përmbajnë parregullsi ose është në pyetje vlefshmëria e dokumenteve, ZKK-ja do të kërkoj nga Gjykata kompetente të qartësoj parregullësitë apo dokumentet me vlefshmëri të pasigurt, ashtu që aplikanti të paraqes dokumentacion shtesë”*. Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se e paditura në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale në ndërlidhje me gjendjen faktike të vërtetuar drejtë.

Mbi këtë bazë, gjykata i pranoi si të ligjshëm dhe të drejtë refuzimin e të paditurës ndaj ankesës së palës dhe në lidhje me këtë, gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar siç duhet ligjin material, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vendosur në tërësi konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerëson se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësve, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj gjykata përfundimisht konstatoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësit. Mbi këto arsye thëniet e paditësve në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.200/2018, datë: 23.02.2023

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Numri i lëndës: 2019:269658
Datë: 23.02.2023
Numri i dokumentit: 04005899

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.